



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2020:087494

Datë: 08.05.2024

Numri i dokumentit: 05666773

**C.nr.1019/20**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Edije Sezairi, me praktikanten gjyqësore M.D. duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit S. (R) B. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson i autorizuari avokat Y.K. nga Prizreni, kundër të paditurës M. (A) O. nga Prizreni, për vërtetimin e pronësisë, vlera e kontestit 900.00 euro me datë 24.04.2024, morri këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET në tërësi si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit S. (R) B. nga Prizren, **VËRTETOHET** se i njëjti në bazë të blerjes dhe ndërtimit është pronar i patundshmërisë në sipërfaqe prej 392 m<sup>2</sup>, që evidentohet si njesi kadastrale nr.05442-24 ZK Prizren, parcela e cila është objekt i këtij kontesti sipas të dhënave grafike zyrtare nga ana veriore kufizohet me parcelën nr.5442-017, nga ana lindore me parcelat nr.5442-5 dhe 5442-6, nga ana juglindore me parcelën nr.5442-25, nga ana jugperendimore me parcelën nr.5442-15, nga ana perendimore me parcelën nr.5441-2. skica përcjellëse konsiderohet si pjesë përbërëse e këtij aktgjykimi, dhe **detyrohen** e paditura M.A.O. nga Prizreni ..... që ta pranojë këtë fakt dhe që të lejojë regjistrimin e kësaj pjese të paluajtshmërisë në emër të paditësit, pranë Drejtorisë së Gjeodezisë dhe të Kadastrës në Komunën e Prizrenit, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë .

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësit S. (R) B. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson i autorizuari avokat Y.K. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate fillimisht ka parashtruar padi më datë 22.07.2020, kundër të paditurës M. (A) O. nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të pronësisë.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datën 24.04.2024, pas administrimit të të gjitha provave të propozuara, përkatësisht në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit ka deklaruar se meqenëse e paditura e pranoi kërkesëpadinë e precizuar si në shqyrtimin e sotëm, I

Numri i lëndës: 2020:087494  
Datë: 08.05.2024  
Numri i dokumentit: 05666773

propozoj gjykatës që të aprovojë në tërësi kërkespadinë e paditësit të precizuar në seancët e sotme, nuk I kërkojmë shpenzimet procedural.

E paditura në fjalën përfundimtare deklaron se në tërësi e pranoj kërkesçadinë e paditësit të precizuar dhe pranoj që të regjistrohet si pronar në ngastrën e kërkuar dhe nik I kërkoj shpenzimet e procedurës.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 148 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e mori duke u bazuar në nenin 452 të LPK-së, e kjo për faktin se asnjëra prej palëve nuk i ka kërkuar ato.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr.1019/20 datë 24.04.2024**

**Gjyqtarja**  
**Edije Sezairi**

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate. Bazuar në nenin 181.2 të LPK-së, ky aktgjykim mund të goditet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkak se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin eventual të dhunës apo mashtrimit.